

GJYKATA SUPREME E KOSOVES
Ap-Kz. 307/2012

28 shtator 2012

NE EMER TE POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVES, ne kolegjin per te mitur te perbere prej Francesco Florit si Kryetar i kolegjit dhe gjyqtaret e Gjykates Supreme Nesrin Lushta, Emine Mustafa dhe Salih Toplica dhe gjyqtari i EULEX-it Dr Horst Proetel si anetare te kolegjit, me asistimin e Keshilltares Ligjore Lendita Berisha e cila vepron ne cilesine e procesmbajtases,

Ne lenden penale kunder te pandehurve:

I.I., i biri i R. dhe A., i lindur me xxx, ne fshatin xxx, komuna e Kamenices, aktualisht me vendbanim ne te njejten adrese, i martuar, baba i xxx femijeve, shites, ka te mbaruar shkollen e mesme, me gjendje te mesme ekonomike,

I denuar me 11 janar 2011 per veprat penale te *Trafikim me njerez*, ne kundershtim te Nenit 139, paragrafi 2 te lexuar ne lidhje me paragrafin 1 te Kodit Penal te Kosoves (KPK) dhe Nenin 23 te KPK, dhe i denuar me 1 (nje) vjet burgim, koha e kaluar ne paraburgim qe nga 7 janar 2011 deri me 3 prill 2011 dhe arresti shtepiak nga 3 prill 2011 deri me 13 maj 2011 llogaritet ne denim;

R.K., i biri i S. dhe Gj., i lindur me xxx, ne fshatin xxx, komuna e Kamenices, aktualisht me vendbanim ne te njejten adrese, i martuar, baba i pese femijeve, saldues, me gjendje ekonomike mesatare,

I denuar me 11 janar 2011 per veprat penale te *Trafikim me njerez*, ne kundershtim te Nenit 139, paragrafi 2 te lexuar ne lidhje me paragrafin 1 te Kodit Penal te Kosoves (KPK) dhe Nenin 23 te KPK, dhe i denuar me 1 (nje) vjet burgim;

M.K., i biri i S. dhe Gj., i lindur me xxx, ne fshatin xxx, komuna e Kamenices, aktualisht me vendbanim ne te njejten adrese, i martuar, baba i xxx femijeve, pronar i restorantit, me gjendje te dobet ekonomike,

I denuar me 11 janar 2011 per veprat penale te *Trafikim me njerez*, ne kundershtim te Nenit 139, paragrafi 2 te lexuar ne lidhje me paragrafin 1 dhe Nenin 23 te te Kodit Penal te Kosoves (KPK) dhe *Cenimi i te Drejtave nga Marredheniet e Punes* ne kundershtim te Nenit 182 te KPK dhe ndaj tij eshte shqiptuar nje denim unik prej 1 (nje) vjet dhe 1 (nje) muaj burgim;

Sh.G., me nofken P., i biri i I. dhe F., i lindur me xxx ne xxx, komuna e Prizrenit, aktualisht me vendbanim ne te njejten adrese, i martuar, baba i xxx, pronar i restorantit, ka te mbaruar shkollen e mesme, me gjendje te dobet ekonomike,

I denuar me 11 janar 2011 per veprat penale te *Trafikim me njerez*, ne kundershtim te Nenit 139, paragrafi 2 te lexuar ne lidhje me paragrafin 1 te KPK dhe Nenin 23 te KPK, per *Privim i kunderligjshem nga Liria*, ne kundershtim te Nenit 162 paragrafi 1 dhe 4 te KPK dhe *Cenimi i te Drejtave nga Marredheniet e Punes* ne kundershtim te Nenit 182 te KPK, dhe ndaj tij eshte shqiptuar nje denim unik prej 4 (kater) vjet e 1 (nje) muaj burgim. Koha e kaluar ne paraburgim nga 6 janar 2011 deri me 11 janar 2012 llogaritet ne denim;

V.M., i biri i B. dhe G., i lindur me xxx, aktualisht me duke jetuar ne lagjen xxx, i pamartuar, vozites, ka te mbaruar shkollen e mesme, me gjendje te dobet ekonomike,

I denuar me 11 janar 2011 per veprat penale te *Lehtesim nga Pakujdesia per Trafikim te Njerezve* ne kundershtim te Nenit 139, paragrafi 4 te KPK, dhe i denuar me 7 (shtate) muaj burgim, koha e kaluar ne paraburgim nga 5 janar 2011 deri me 3 prill 2011 dhe ne arrest shtepiak nga 3 prill 2011 deri me 13 maj 2011 llogaritet ne denim;

S.B., me noflken C., i biri i I. dhe H., i lindur me xxx, aktualisht me vendbanim ne lagjen xxx, beqar, punetor, ka te mbaruar shkollen fillore, me gjendje te dobet financiare,

I denuar me 11 janar 2011 per veprat penale te *Trafikim me njerez*, ne kundershtim te Nenit 139, paragrafi 2 te lexuar ne lidhje me paragrafin 1 te KPK dhe Nenin 23 te KPK dhe *Keqperdorimi seksual i personave nen moshen gjashtembedhete vjet*, ne kundershtim te Nenit 198 paragrafi 1 te KPK, dhe ndaj tij eshte shqiptuar nje denim unik prej 1 (nje) viti e 1 (nje) muaj burgim. Koha e kaluar ne paraburgim nga 6 janar 2011 deri me 11 nentor 2011 llogaritet ne denim;

D.B., i biri i N. dhe Sh., i lindur me xxx, aktualisht me vendbanim ne xxx, beqar, menaxher, me gjendje te dobet materiale,

I denuar me 11 janar 2011 per veprat penale te *Trafikim me njerez*, ne kundershtim te Nenit 139, paragrafi 2 te lexuar ne lidhje me paragrafm 1 te KPK dhe Nenin 23 te KPK dhe *Keqperdorimi seksual i personave nen moshen gjashtembedhete vjet*, ne kundershtim te Nenit 198 paragrafi 1 te KPK dhe *Cenimi i te Drejtave nga Marredheniet e Punes* ne kundershtim te Nenit 182 te KPK, dhe ndaj tij eshte shqiptuar nje denim unik prej 2 (dy) vjet burgim. Koha e kaluar ne paraburgim nga 7 janar 2011 deri me 11 nentor 2011 llogaritet ne denim;

E.K., i biri i R.dhe M., i lindur me xxx, aktualisht me vendbanim ne rrugen xxx i martuar, pronar i hotelit, me gjendje materiale mesatare,

I denuar me 11 janar 2011 per veprat penale te *Trafikim me njerez*, ne kundershtim te Nenit 139, paragrafi 2 te lexuar ne lidhje me paragrafm 1 dhe Nenin 23 te Kodit penal te Kosoves (KPK), dhe te dhe *Cenimi i te Drejtave nga Marredheniet e Punes* ne kundershtim te Nenit 182 te KPK, dhe ndaj tij eshte shqiptuar nje denim unik prej 1 (nje) vjet e 3 (tre) muaj burgim. Koha e kaluar ne paraburgim qe nga 5 janar 2011 deri me 22 mars 2011 llogaritet ne denim;

Duke vepruar sipas ankeses te ushtruar nga Zyra e Prokurorise se Qarkut ne Prizren, ankesave te ushtruara nga avokatet mbrojtes H.K.(i pandehuri **I.I.**), B.B.(i pandehuri **R.K.**), H.S. (i pandehuri **Sh.G.**), B.S.(i pandehuri **V.M.**), R.K.(i pandehuri **D.B.**), H.M. (i pandehuri **E.K.**), kunder aktgjykimit P nr. 184/11 te Gjykates se Qarkut ne Prizren te dates 11 janar 2011, dhe duke pasur parasysh Mendimin e Zyres se Prokurorit te Shtetit te Kosoves (ZPShK) te paraqitur me 23 gusht 2012,

Pas mbajtjes se seances te hapur me 28 gusht 2012 ne pranine e te pandehurve **R.K.**, **Sh.G.**, **V.M.**, **S.B.**, **D.B.**, **E.K.** dhe avokateve mbrojtes H.S., B.S., R.K.dhe H.M., ne pranine e Prokurorit te Shtetit Laura Pula, pas keshillimit dhe votimit ne te njejten dite;

Ne pajtueshmeri me Nenet 420 dhe me tej te Kodit te Procedures Penale te Kosoves (KPPK), leshon kete

AKTGJYKIM

Aktgjykimi P nr. 184/11 i Gjykates se Qarkut ne Prizren i dates 11 janar 2011 modifikohet me sa vijon:

I. Aukesa e Prokurorit te Qarkut ne Prizren pranohet pjeserisht ne lidhje me denimet e shqiptuara ndaj I.I., Sh.G., S.B. dhe D.B.. Prandaj te pandehurit e permendur denohen me sa vijon:

a) **I.I.**

- ne pajtueshmeri me Nenin 139, paragrafi 1 dhe 2 dhe 23 te KPK, ne lidhje me Nenin 66.2 dhe Nenin 67 para 1, nen para 2 te KPK i pandehuri denohet me 2 vjet burgim;
- b) Sh.G.
- ne pajtueshmeri me Nenin 139, paragrafi 1 dhe 2 dhe 23 te KPK i pandehuri denohet me 3 vjet burgim;
- ne pajtueshmeri me Nenin 162, paragrafi 1 dhe 4 te KPK, i pandehuri denohet me 1 vit burgim;
- ne pajtueshmeri me Nenin 182 te KPK, i pandehuri u denua me 6 muaj burgim;
- bazuar ne Nenin 71 paragrafi 1 dhe 2, n.2 te KPK i pandehuri Sh.G. do te vuaj denimin prej 4 vjet e nje muaj burgim.

c) S.B.

- ne pajtueshmeri me Nenin 139, paragrafi 1 dhe 2 dhe 23 te KPK, ne lidhje me Nenin 66 par 2 dhe Nenin 67 para 1, nen para 2 te KPK i pandehuri denohet me 1 vjet burgim;
- ne pajtueshmeri me Nenin 198 para 1 te KPK, i pandehuri denohet me 1 vjet burgim;
- bazuar ne Nenin 71 paragrafi 1 dhe 2, n.2 te KPK i pandehuri S.B. do te vuaj denimin prej 1 vjet dhe 6 muaj burgim.

d) D.B.

- ne pajtueshmeri me Nenin 139, paragrafi 1 dhe 2 dhe 23 te KPK, ne lidhje me Nenin 66 par 2 dhe Nenin 67 para 1, nen para 2 te KPK i pandehuri denohet me 1 vjet burgim;
- ne pajtueshmeri me Nenin 198 para 1 te KPK, i pandehuri denohet me 1 vjet burgim;
- ne pajtueshmeri me Nenin 182 te KPK, i pandehuri denohet me 6 muaj burgim;
- bazuar ne Nenin 71 paragrafi 1 dhe 2, n.2 te KPK i pandehuri D.B. do te vuaj denimin prej 2 vjet e kater muaj burgim.

II. Ankesa e avokatit mbrojtës Bahrije Besimi pranohet. Aktgjykimi modifikohet dhe i pandehuri R.K. lirohet ne pajtueshmeri me Nenin 390 paragrafi 3 te KPPK sepse nuk eshte provuar se i akuzuari ka kryer veprat per te cilat ai eshte akuzuar.

III. Ankesa e avokatit mbrojtës H.M. pranohet pjeserisht. Prandaj denimi i shqiptuar ndaj te pandehurit E.K. modifikohet me sa vijon:

- ne pajtueshmeri me Nenin 139, paragrafin 1 dhe 2 dhe 23 te KPK, ne lidhje me Nenin 66 par 2 dhe Nenin 67 para 1, nen para 2 te KPK i pandehuri denohet me 1 vjet burgim;
- ne pajtueshmeri me Nenin 182 te KPK, i pandehuri denohet me 2 muaj burgim;
- bazuar ne Nenin 71 paragrafi 1 dhe 2, n.2 te KPK i pandehuri E.K. do te vuaj denimin prej 1 vjet e 1 muaj burgim.

Ankesat e avokateve mbrojtës H.K., H.S., B.S. dhe R.K.refuzohen si te pabazuara.

IV. Procedura penale kunder M.K. pushohet ne pajtueshmeri me Nenin 145 te KPPK.

Aktgjykimi P nr. 184/11 i Gjykates se Qarkut ne Prizren i dates 11 janar 2011 konfirmohet ne pjesen e mbetur.

Arsyetimi

I. Historia e Procedures

Me 17 maj 2011 Prokurori Publik i Qarkut ne Prizren ka ngritur aktakuzen PP.nr.3/2011 kunder te pandehurve. Aktakuza eshte konfirmuar me aktvendimet KA.no. 109/11 te 28 korrik 2011 dhe 2 shtator 2011'.

Ne lenden aktuale, veprimtarite penale te te pandehurve kryesisht perbehen prej Trafikim me Njerez dhe vepra penale pasuese/te rezultuara te kryera ne periudhen ne mes te fundit te nentorit/fillimi i dhjetorit 2010 deri ne mes te janar 2011. Pale e demtuar nga aktivitetet penale te te pandehurve eshte **A.K.**, nje e mitur e moshes 15 (pesembedhete vjec). Me date te panjohur, ne fund te nentorit/fillim te dhjetorit 2010, **F.T.**, nga xxx, Republika e Shqiperise, ne menyre te kunderligjshme solli palen e demtuar ne Kosove. Me pas **F.T.** ka kontaktuar **I.I.**, me te cilin ka transportuar palen e demtuar te mituren nga Shtimja ne Gjilan. Ne daten pasuese, qe te dyte, **I.I.** and **F.T.** transferuan palen e demtuar te bashke te pandehurit **R.K.** dhe **M.K.**, menaxher dhe pronar i restorantit "xxx" ne xxx, ne te cilin, ajo ishte detyruar te mbetej dhe punonte si valltare gjate nates per se paku tri dite. Me pas, **F.T.** e mori dhe e transferoi palen e demtuar te **Sh.G.**, pronar i restorantit "xxx" ne fshatin xxx, komuna e Prizrenit ku ajo u detyruar te mbetej dhe punonte si valltare gjate nates per se paku pese dite. I pandehuri, **Sh.G.** e ka mbyllur palen e demtuar ne dhome ne katin e siperm te restorantit dhe pastaj kur ajo u perpoq te ikte nga dhoma i pandehuri me ndihmen e punetoreve te tij, e kane kthyer ate detyrueshem ne restorant ku qendroi per tri dite. Me date te panjohur, ne mes te dhjetor 2010 pala e demtuar ka arritur te ik nga restoranti i **Sh.G.** dhe rrjedhimisht ajo takoi bashke te pandehurit **V.M.** dhe **S.B.**. Me kerkese te **S.B.**, **V.M.** transportoi palen e demtuar me veturen e tij ne motelin "xxx" ne xxx, pagoi per dhomen e saj dhe ia dha asaj numrin e telefonit te **S.B.**. Gjate diteve ne vijim, **S.B.** ka pasur marredhenie seksuale me viktimen e mitur ne shtepine e dhendrit te axhes te **V.M.** dhe ne shtepine e tij ne rrugen "xxx" ne xxx. Me 24 dhjetor 2010 ai e transferoi palen e demtuar te **D.B.** menaxher i "xxx" ku ajo u punesua si kamerier gjate nates. Gjate periudhes prej 24 deri me 31 dhjetor 2010 **D.B.** po ashtu ka keqperdorur palen e demtuar duke pasur marredhenie seksuale me te ne vende te ndryshme. Me 5 janar 2011 pala e demtuar e mitur u transferua nga dy njerez te panjohur te **E.K.** pronar i restorantit "xxx" ne xxx. Pronari e ka punesuar ate te punoj si valltare gjate nates.

Shqyrtimi gjyqesor ka filluar me 8 nentor 2011 ne Gjykatën e Qarkut ne Prizren dhe vazhdoi gjate shtate seancave me 9 dhe 10 nentor, 6, 7, 15 dhe 21 dhjetor 2011 dhe me 10 janar 2012. Te pandehurit si edhe nje numer i larte i deshmitareve (duke perfshire palen e demtuar) jane marre ne pyetje; dhe eshte shqyrtuar raporti i shtypur per porosite hyres dhe dalese per numrat e telefonit te permendur ne aktakuze dhe transkriptimet e regjistrimeve te bisedave telefonike te **V.M.** me nje person te panjohur me 5 janar 2011.

Me 11 janar 2011, Gjykata e Qarkut ka shpallur aktgjykimin dhe te pandehurit jane gjetur fajtor per veprat penale te renditura me lart.

II. Parashtrësit e paleve:

II. I Ankesa e ushtruar nga Zyra e Prokurorit te Qarkut ne Prizren me 22 mars 2011

Prokurori i Qarkut ka kerkuar nga Gjykata Supreme te ndryshoj aktgjykimin e ankimuar dhe te shqiptoj nje denim me te ashper ndaj te pandehurve.

Sipas Prokurorit te Qarkut, gjykata e shkalles se pare kur ka dhene vendimin mbi denimin ka deshtuar te vleresoj rrethanat lehtesuese dhe renduese te cilat kane ekzistuar ne anen e te pandehurve dhe posagerisht ka deshtuar te vleresoj rrethanat e kryeijes se veprave penale nga te pandehurit.

Me denimin e shqiptuar eshte e pamundur te arrihet qellimi i denimit kunder te pandehurve lidhur me parandalimin e kryeresve nga kryeija ne te ardhmen e veprave penale dhe po ashtu te ndikoj ne njerez te tjere per t'i parandaluar te kryejne vepra penale.

PPQ ka sugjeruar gjykatën e shkalles se dyte te vleresoj nivelin e pergjegjesive penale te pandehurve, rrezikun social te veprave penale te kryera duke pasur parasysh qe pala e demtuar ne kete lende ishte nje vajze e mitur e moshes pesembedhete vje9 e cila ishte keqperdorur ne maksimum.

II.2. Ankesat e ushtruara nga avokatet mbrojtës

Ne ankesat e tyre, avokatet mbrojtës te te pandehurve kane pretenduar per shkelje substanciale te dispozitave te ligjit procedural, vertetim te gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike, per shkelje te ligjit penale dhe per vendimin mbi denimin. Ne pergjithesi, avokatet mbrojtës ishin me shume te perqendruar ne kontestimin e rikonstruksionit faktik te bere nga kolegji i shkalles se pare ne lidhje me te mbrojturit e tyre, duke i vleresuar keto elemente te cilat kane mundur te sjellin vleresimin e pergjegjesise se tyre penale. Mbrojtësit i propozojne Gjykatës Supreme te Kosoves te ndryshoj aktgjykimin dhe te liroj te pandehurit nga akuza e sjelle kunder tyre; apo te prish aktgjykimin dhe te kthej lenden ne rigjykim, apo te ndryshoj aktgjykimin lidhur me vertetimin e denimit duke shqiptuar denim me te bute ndaj tyre.

III. GJETJETE GJYKATES

A. Pranueshmeria e ankesave

Gjykata Supreme e Kosoves konstaton se te gjitha ankesat e mbrojtjes si edhe ajo e Prokurorit Publik te Qarkut ne Prizren jane ushtruar ne kohe dhe jane te pranueshme.

¹ Aktakuza lidhur me akuzat per kryerjen e vepres penaie te Trafikim i njerezve nen Nenin 139 paragrafi 2 te lexuar ne lidhje me paragrafin 1 te KPPK eshte konfirmuar vetem kunder te pandehurit S.B. dhe D.B. (Aktvendimi per konflrmim KA.nr. 109/11 i dates 28 korrik 2011).

Sipas ankeses se Prokurorit te EULEX-it, kolegji prej tre gjyqtare i Gjykatës se Qarkut ne Prizren konfirmoi aktakuzen e ngritur kunder I.I., R.K., M.K., Sh.B. dhe E.K. per vepren penale te permendur. Me te njejtin aktvendim eshte kontlrnuar aktakuza edhe kunder te pandehurit V.B. per vepren penale te Trafikim me njerez ne shkelje te Nenit 139 paragrafi 4 te KPK (Aktvendimi KA.nr.109/11 i dates 2 shtator 2011).

Gjykata Supreme e Kosoves ka mbajtur seancen e saj te kolegjit konform dispozitave te Nenit 410 te KPPK; ne seance kane marre pjese edhe te pandehurit **R.K., Sh.G., V.M., S.B., D.B., E.K.** dhe avokatet mbrojtës H.S., B.S., R.K.dhe H.M., dhe Prokurori i Shtetit Laura Pula. Avokatet mbrojtës H.K. (per **I.I.**) dhe B.B.(**R.K.**) mungonin edhe pse jane ftuar me rregull.

Gjykata vendosi te mbaj seancen.ne pajtueshmeri me Nenin 410 paragrafi 4 te KPPK pa pranine e te pandehurit I.I., sepse ai nuk ka lajmeruar per nderrimin e perkohshem te adreses. Njoftimi i derguar te pandehurit eshte kthyer me verejtjen "e pa dorezuar" - dhe sipas te afermeve te tij, ai eshte ne Zvicer.

Gjate seances, Prokurori i Shtetit propozoi qe ankesa e Prokurorit Publik ne Prizren te pranohet sepse konsideroi qe denimet ishin tejet te buta duke pasur parasysh peshen e vepres penale, rrezikun social dhe pasojat e vuajtura nga pala e demtuar. Pervec kesaj, ZPShK ka kerkuar nga Gjykata Supreme te refuzoj ankesat e avokateve mbrojtës si te pabazuara.

Avokatet mbrojtës pohuan se ata teresisht mbeten prapa ankesave dhe propozimeve te paraqitura ne to.

B. Meritat e Ankesave

Gjykata Supreme e Kosoves paraprakisht do te shqyrtoj geshtjen e perberjes se kolegjit dhe ceshtjen ne lidhje me zhvillimin e shqyrtimit gjyqesor dhe mbylljen e tij per publikun te ngritur nga avokati mbrojtës H.K..

Perberja e kolegjit

Kolegji i gjykates se shkalles se pare i cili ka gjykuar dhe leshuar aktgjykimin e ankimuar ka qene i perbere nga nje gjyqtar i EULEX-it si Kryetar kolegji per te mitur dhe dy gjyqtare te tjere vendor.

Ne lenden ne fjale pala e demtuar eshte e mitur e cila ne kohën kur kane ndodhur krimet ishte vetem 15 vjege. Heqja nga kushti i Nenit 51 paragrafi 1 dhe 3 i Kodit te Kosoves per te Mitur ne lidhje me perbeijen e kolegjit eshte e pranueshme bazuar ne Nenin 3.7 te Ligjit mbi Kompetencat, perzgjedhja e lendeve dhe caktimi i lendeve te gjyqtareve dhe prokuroreve te EULEX-it ne Kosove, Ligji nr. 03/L-053, i cili parasheh qe gjyqtaret e EULEX-it te gjykojne lendet ne kolegje te perziera te perbere nga gjyqtare profesional.

Prandaj, Gjykata Supreme konstaton se nuk ka shkelje te dispozitave procedurale ne lidhje me perbeijen e kolegjit.

Publiciteti i shqyrtimit gjyqesor

Sikurse eshte permendur ne aktgjykimin e ankimuar, seancat e shqyrtimit gjyqesor ishin te mbyllura per publikun. Pala e demtuar eshte percjelle nga punetori social nga Britania e Madhe gjate kohes sa ishte duke qendruar ne Kosove per te marre pjese ne seancat e shqyrtimit gjyqesor. Ajo ka dhene deklaratën /deshmine e saj ne nje dhome qe ishte e ndare nga salla e gjykates. Dhomat ishin te ndara me xham nga te cilet pjesemarresit e pranishem ne seance nuk mund ta shihnin palen e demtuar. Nga procesverbali i shqyrtimit gjyqesor eshte kuptuar se trupi gjykues ka lejuar nga nje anetar te familjes te secilit te pandehur qe te jete i pranishem ne seance, ndersa ne seancen e fundit jane lejuar qe te jene te pranishem tre studente.

Sipas Nenit 330 te KPPK trupi gjykues mund te miratoj lejimin per zyrtare te caktuar, akademik, figura publike dhe me kerkese te te akuzuarit, edhe bashkeshorten apo partneren jashte martesore te te akuzuarit dhe te afermit e tij apo saj qe te marrin pjesen ne shqyrtim gjyqesor i cili nuk eshte i hapur per publikun.

Gjykata Supreme konstaton se nuk ka pasur shkelje te kodit procedural lidhur me kete ^eshtje bazuar ne faktin se seanca e shqyrtimit gjyqesor eshte mbajtur vetem ne pranine e personave te cilet ligji i lejon te jene te pranishem.

Gjykata Supreme do te paraqes konstatimet e saj a lidhur me secilin te pandehur me sa vijon:

Lidhur me te pandehurin I.I.

Ne kundershtim me argumentet e vena nga mbrojtja, Gjykata Supreme konsideron qe arsyetimi i aktgjykimit eshte i plote dhe permaban listen e te gjitha provave te cilat jane analizuar gjate shqyrtimit gjyqesor dhe vleresimin e besueshmerise se provave kontradiktore dhe arsyet me te cilat gjykata ishte udhezuar ne vertetimin e ekzistimit te nje vepre penale dhe pergjegjesise penale te te pandehurit.

Sipas kend veshtrimit te Gjykates Supreme, gjykata e shkalles se pare ka vleresuar drejt te gjitha provat dhe duke u bazuar ne to ka vertetuar gjendjen faktike. Ajo ve ne pah se i pandehuri nuk

mund te mohoj se ishte ne dijeni per moshen e pales se demtuar. Ai ishte i pari me te cilen ka kontaktuar Fatri Toqilla pasi qe kane hyre ne Kosove dhe ai ishte deshmitar i gjendjes se mjerueshme te pales se demtuar. Megjithate ai bashke me F.T. ka transportuar dhe transferuar palen e demtuar te restoranti ku ajo eshte dashur te punoj si valltare. Veprimet e tij jane pertej bejjes se nje nderi bashke partnerit, sikurse ai eshte duke pretenduar. Pa te do te ishte i pamundur transportimi dhe transferimi i pales se demtuar deri ne restorantin xxx. Ai ishte klient i rregullt ne restorantin e permendur, prandaj e dinte menyren se si valltaret trajtoheshin nga ana e klienteve. Prandaj, eshte e qarte se ne kete menyre ai kontribuonte ne shfrytezimin e saj qe ishte filluar nga F.T.. Duhet te theksohet se veprimet e tija permbajne te gjitha elementet e vepres penale per te cilen eshte ngarkuar, sip jane transportimi, transferimi dhe aranzhimi i punesimit te saj me qellim te shfrytezimit. Per me teper, ligji percakton qe qellimi i trafikimit te personave eshte shfrytezimi, por nuk kerkon qe kryeresi te jete perfitues i drejtperdrejte. Fakti qe i pandehuri nuk kishte pasur perfitim te drejtperdrejte ne tere kete ngjajje nuk pasqyron pergjegjesine e tij penale. Gjykata Supreme pajtohet me vleresimin e gjykates se shkalles se pare qe shfrytezimi nuk eshte i kufizuar vetem ne ato situata ne te cilat kryeresi ka arritur nje perfitim per veten e tij.

Gjykata Supreme konstaton se aktgjykimi i Gjykates se Qarkut nuk permban asnje shkelje te dispozitave procedurale; gjendja faktike eshte vertetuar drejt; prandaj ankesa e te pandehurit duhet te refuzohet si e pabaze.

Gjykata e shkalles se pare ka denuar te pandehurin me denimin prej nje viti burgim duke pasur parasysh si rrethane lehtesuese faktin qe i njejti eshte perceptuar nga pala e demtuar si nje person qe i kishte ndihmuar asaj.

Gjykata Supreme e Kosoves pajtohet me prokurorin publik qe denimi i shqiptuar ndaj te pandehurit eshte shume i bute. Duke pasur parasysh veprimet e ndermarra nga i pandehuri si dhe rrethanat ne te cilat i njejti kishte vepruar, perkushtimi dhe gatishmeria e tij per ta transportuar dhe bartur palen e demtuar duke qene ne dijeni rreth moshes se saj dhe gjendjes se saj te veshtire, varesise nga narkotiket, faktit se ajo ishte e vetme ne nje shtet te huaj, pa pasur ndonje mundesi te kthehej ne shtepi prane familjes, Gjykata Supreme duke u bazuar ne nenin 420, par. 4, lidhur me nenin 426, par. 1 te KPPK-se e ndryshon aktgjykimin dhe shqipton nje denim me te rende. Sipas nenit 139, par. 1 dhe 2 dhe 23 te KPK-se, lidhur me nenin 66, par. 2 dhe nenin 67, par. 1, nenpar. 2 te KPK-se, Gjykata Supreme e Kosoves percakton per te pandehurin denimin ne kohezgjatje prej 2 vjetesh burgim.

Lidhur me te pandehurin Sh.G.

Mbrojtja pohon se aktgjykimi i apeluar permes te cilit i pandehuri eshte shpallur fajtor eshte bazuar vetem ne deklarimin e pales se demtuar A.K..

Gjykata Supreme konstaton se gjykata e shkalles se pare ka marre parasysh deklarimin e pales se demtuar, deshmitet e deshmitareve (G.G., B.H. dhe B.L. kane konfirmuar se pala e demtuar ka punuar si valltare ne restorantin xxx; me pastaj B.H. ka deshmuar se naten kritike pala e demtuar eshte sjelle ne restaurant nga 4 veta) dhe deshmime e te pandehurit. Ne rastet e trafikimit me njerez, eshte me rendesi te permendet se pala e demtuar eshte pala me e besueshme per shkak te faktit se ai / ajo eshte e perfshire direkt si viktime dhe "e din" situaten me mire. Ne rastin ne Qale, eshte e ditur se ne gfare menyre pala e demtuar ka perfunduar para organeve te drejtetise, prandaj, eshte e qarte se ajo ka pershkruar situaten ashtu si? ka qene pa pasur ndonje qellim per ta demtuar asnje njeri. Keshtu, duke pasur parasysh kete dhe moshen e saj te re, naivitetin e saj dhe ne vepanti gjendjen ne te cilen ajo u gjet pa vullnetin e vet, e pambrojtur, e rrethuar me njerez te panjohur, larg familjes, pa shprese per t'u kthyer ne shtepi eshte me se e qarte se ajo ka thene te verteten; prandaj, justifikohet qe gjykata e shkalles se pare ka bazuar vendimin e saj ne deshmite e pales se demtuar.

Mbrojtja ka kundërshtuar vertetimin e gjendjes faktike lidhur me veprat penale nen pikat 1 dhe 2 te aktgjykimit te apeluar duke konsideruar se ne kete incident e vetmja veper penale e kryer nga i

n
/

pandehuri eshte shkelja e se drejtes se punesimit sepse ai kishte punesuar nje vajze te re pa e ditur moshen e saj per te punuar ne restorant dhe ate ne turnin e nates.

Per ndryshim nga mbrojtja, Gjykata Supreme konsideron se veprimet e te pandehurit lidhur me palen e demtuar perbejne elemente te vepres penale te trafikimit me njerez dhe privim te kunderligjshem nga liria. I pandehuri ka pranuar palen e demtuar nga nje njeri gati te panjohur dhe i ka siguruar se njejtes banese me synim qe te njejten ta shfrytezonte duke e punesuar si valltare. Si menaxher i restorantit, nuk ishte e veshitore per te qe te merrte vesh se pala e demtuar ishte e moshes se re dhe ishte viktime e trafikimit. Duke e pranuar viktimen nga **F.T.**, ai mori kontrollin siper saj dhe gjate periudhes sa kishte punuar ajo ne restorantin e tij ai e trajtonte te njejten si nje pasuri te çmuar te tij. Nese nje gje e tille nuk qendron, atehere pse dikush qe e konsideron veten punedhenes do te reagonte ne menyren si reagoi i pandehuri kur pala e demtuar po flirtonte me klientin prane deres se banjes? Ne qofte se ajo ishte "vetem" punetore e tij, atehere pse i njeiti e kishte mbyllur me dry palen e demtuar ne dhomen ne katin me te siperme te restorantit pasi qe mori vesh se ajo kishte deshire te ikte dhe pastaj, pasi kishte ikur per dritare, pse e kishte kthyer prape ne te njejten dhome dhe e kishte mbajtur mbyllur edhe per tri dite tjera?

Keshtu, Gjykata Supreme konstaton se gjykata e shkalles se pare me te drejte ka vertetuar se i pandehuri ka kryer te tri veprat penale me te cilat eshte ngarkuar; prandaj edhe e refuzon ankesen e ushtruar nga mbrojtja si te pabaze.

Gjykata e shkalles se pare ka denuar te pandehurin me denimin prej kater vjet e nje muaj burgim duke e theksuar se nuk kishte verejtur asnje rrethane lehtesuese.

Duke pasur parasysh shkallen e pergjegjesise penale, motivet per kryeijen e vepres dhe rrethanat ne te cilat ishin kryer veprat ne fjale, Gjykata Supreme pajtohet ne parim me denimin e shqiptuar nga ana e gjykates se shkalles se pare. Megjithate, Gjykata Supreme e ndryshon kohezgjatjen e denimit te shqiptuar lidhur me veprat individuale penaie, duke e denuar te pandehurin per vepren penale te trafikimit me njerez sipas nenit 139, par. 1 dhe 2 e 23 te KPK-se me tre (3) vjet burgim, per vepren penale te privimit te kunderligjshem nga liria sipas nenit 162, par. 1 dhe 4 te KPK-se me nje (1) vit burgim ndersa per shkeljen e te drejtave te punesimit sipas nenit 182 te KPK-se me gjashte (6) muaj burgim.

Ne pajtim me kete qe u tha me lart, Gjykata Supreme e Kosoves, ne baze te nenit 71, par. 1 dhe 2, nenit 2 te KPK-se i shqipton te pandehurit denimin unik ne kohezgjatje prej kater (4) vjet e nje (1) muaj burgim.

Lidhur me te pandehurin S.B.

Gjykata e shkalles se pare ka denuar te pandehurin me denimin unik prej nje viti e nje muaji burgim duke pasur parasysh si rrethane lehtesuese faktin qe i njeiti ka qene nje ndermjetes pa ndonje fuqi vendimtare dhe per shkak se nuk kishte nxjerre kurrfare perfitimi per veten nga kjo pune.

Gjykata Supreme e Kosoves pajtohet me qendrimin e prokurorit publik te qarkut se denimi i shqiptuar ndaj te pandehurit eshte shume i bute. Duke pasur parasysh perkushtimin e tij per ta punesuar palen e demtuar ne barin ne te cilin nga viktimat kerkohej te punonte gjate turnit te nates si dhe faktin qe ajo kishte pasur marredhenie seksuale me te, duke qene ne dijeni rreth moshes se saj dhe gjendjes se rende, Gjykata Supreme duke u bazuar ne nenin 420, par. 4, lidhur me nenin 426, par. 1 te KPPK-se e ndryshon aktgjykimin ne Qale dhe i shqipton te pandehurit nje denim te te rrepte.

Sipas nenit 139, par. 1 dhe 2 dhe 23 te KPK-se, lidhur me nenin 66, par. 2 dhe nenin 67, par. 1, nenpar. 2 te KPK-se, i pandehuri denohet me burgim prej 1 viti dhe sipas nenit 198, par. 1 te KPK-se i njeiti denohet me nje vit burgim.

Ne perputhje me kete qe u tha me lart, Gjykata Supreme e Kosoves duke u bazuar ne nenin 71, par. 1 dhe 2 dhe nenin 2 te KPK-se i shqipton te pandehurit denimin unik ne kohezgjatje prej gjithsej 1 viti e 6 muaj burgim.

Lidhur me te pandehurin D.B.

Ne pikepamjen e Gjykates Supreme, tashme eshte vertetuar se pala e demtuar eshte sjelle ne restorantin xxx nga ana e **S.B.**. I pandehuri e ka pranuar viktimen perkunder faktit se i njejeti e dinte se viktimia ne Qale ishte e mitur duke e punesuar te njejten si kameriere gjate turnit te nates. Veprimet e te pandehurit nuk mund te interpretohen ndryshe se sa trafikimi i njerezve. Gjithashtu, do te duhej te theksohet qe trafikimi i te miturve nuk perfshin perdorimin e forces apo dhunes, si? eshte supozuar nga mbrojtja. Ne rastin ne fjale, pala e demtuar si i mitur, duke qene i transportuar dhe i transferuar nga nje restorant ne tjetrin nuk ka pasur zgjedhje ne ate pka i ka ndodhur asaj.

Sa i perket vepres penale te Keqperdorimit seksual te personave nen moshen 16 vjepare, faktit qe pala e demtuar eshte pajtuar qe te kete marredhenie seksuale me te pandehurin nuk arsyeton veprimet e tij. Ligji parasheh denim edhe nese vertetohet qe eshte bere me lejen e pales se demtuar. Fakti qe ata jane dehur dhe qe kane pasur marredhenie mundet gjithashtu te interpretohet ne paragjykimin e te pandehurit, sepse ai ishte personi qe i ka ofruar asaj alkool dhe e ka sjelle ne ate gjendje, duke qene i vetedijshem per poziten e saj te cenueshme. Duke iu referuar vepres penale te shkeljes se te drejtave ne marredheniet e punes, nuk eshte kontestuese qe pala e demtuar ka punuar ne kafe-bar pothuajse nje jave si kameriere. Si menaxher i kafe-barit ai do te duhej te dinte qe ligji ndalon punesimin e personave nen moshen 18 vjegare per te punuar ne nderrimin e nates. Fakti qe nuk ekziston kontrate e punes me shkrim sip eshte theksuar nga mbrojtja nuk e liron te pandehurin nga pergjegjesia e tij penale. Ne te kunderten duhet te konsiderohet si rrethane plotesuese renduese kunder tij.

Sa i perket deklarave te pales se demtuar te dhena para polices me 6 janar 2011, pastaj ne prokurori me 11 janar 2011 dhe e fundit e dhene gjate shqyrtimit gjyqesor ku ajo deklaroi "*qe personi qe me se shumti me ka ndihmuar ne jeten time ishte D.B.*", Gjykata Supreme e interpreton si mirenjohje te pales se demtuar ne drejtim te te pandehurit, ndoshta per te hollat qe ai ia dha asaj (70 euro per pune dhe 100 euro per te blere rroba) ose per menyren ne te cilen ajo eshte trajtuar. Megjithate, kjo mirenjohje e viktimes kundrejt viktime beresit nuk eshte e panjohur ne kriminologji si tipar te perceptimit te shtremberuar qe viktimia e cenueshme mund te kete per realitetin e fakteve. Prapeseprape, kjo gjendje mendore nuk ndryshon natyren e veprimeve si kriminale ose si veper si mohim ose rrethane shfajesuese.

Gjykata Supreme gjen se Gjykata e Qarkut ne menyre te rregullt ka percaktuar gjendjen faktike lidhur me veprat penale per te cilat i pandehuri perfundimisht eshte denuar dhe bazuar ne vertetimin e gjendjes faktike ne menyre te sakte ka zbatuar ligjin penal; prandaj e refuzon si te pabazuar ankesen e mbrojtjes.

Gjykata e shkalles se pare e denoi te pandehurin me denim unik- dy vite. Gjykata Supreme e Kosoves pajtohet me prokurorin e qarkut qe denimi i shqiptuar ndaj te pandehurit eshte shume i bute. Duke mare parasysh gatishmerine e tij per te punesuar palen e demtuar ne kafe-bar ne te cilin ajo duhet te punonte ne nderrimin e nates dhe faktit qe ai ka pasur marredhenie seksuale me te, duke qene i vetedijshem per moshen e saj dhe situates se saj te cenueshme, Gjykata Supreme bazuar ne nenin 420 paragrafin 4 i lidhur me nenin 426 paragrafm 1 te KPPK-se ndryshon aktgjykimin dhe i shqipton te pandehurit nje denim me te rende. Ne pajtim me nenin 139, paragrafin 1 dhe 2 dhe nenin 23 te KPK-se i lidhur me nenin 66 paragrafin 2 dhe nenin 67 paragrafin 1, nen-paragrafin 2 te KPK-se i pandehuri eshte denuar me burgim me kohezgjatje prej 1 viti; ne pajtim me nenin 198 paragrafin 1 te KPK-se i pandehuri eshte denuar me burgim ne kohezgjatje prej 1 viti; ne pajtim me nenin 182 te KPK-se i pandehuri eshte denuar me burgim ne kohezgjatje prej 6 muajsh;

Gjykata Supreme e Kosoves bazuar ne nenin 71 paragrafet 1 dhe 2, nen-paragrafin 2 te KPK-se i percakton te pandehurit denim unik me burgim ne kohezgatje prej 2 vite e 4 muaj.

Ne lidhje me te pandehurin V.M.

Mbrojtja argumenton qe veprimet e te pandehurit te pershkruara ne dispozitiv nuk kane kurrfare lidhje ligjore me aktivitetet e mundesimit te trafikimit te njerezve per te cilat ai ishte denuar. Per me teper, nuk ekzistojne prova qe do te mund te deshmonin qe i pandehuri e ka transportuar palen e demtuar me qellim te trafikimit sip pretendohet nga prokuroria. Provat e administruara kane deshmuar qe i pandehuri nuk ka qene fare i perfshire ne veprimtarite e ndaluara.

Nuk eshte kontestuese qe i pandehuri e ka transportuar palen e demtuar me veturen e tij ne motel dhe ka aranzhuar dhomen e motelit per ate. Ai gjithashtu i ka lene asaj numrin e telefonit te **S.B.**, bile qe ai ka qene i vetedijshem qe **S.B.** po tentonte te gjente pune ne nje nga restorantet perreth, ku asaj do ti duhej te punonte gjate nderrimit te nates. Ai nuk ka hezituuar te aranzhoj akomodimin per ate, edhe pse e dinte qe ajo eshte e moshes se re, historine e saj, menyren se si eshte sjelle ne Kosove dhe nga kush.

Sipas kendveshtrimit te Gjykates Supreme pa asistencen e te pandehurit, pala e demtuar nuk do te ishte transferuar ne ndonje kafe-bar tjeter dhe nuk do te kishte qene viktime e trafikimit te metutjeshem. Eshte e qarte qe ai nuk ka vepruar me qellim te shfrytezimit; megjithate ai nuk ka tentuar t'i rezistoj kerkeses se **S.B.**, edhe pse ai ishte i vetedijshem per qellimet e tij. Prandaj, Gjykata Supreme gjen se gjykata e shkalles se pare ne menyre te rregullt ka vertetuar gjendjen faktike dhe pergjegjesine penale te te pandehurit lidhur me vepren penale me te cilen ai eshte denuar.

Sa i perket vendimit mbi denimin, Gjykata Supreme e Kosoves gjen se vleresimi i rrethanave, forma dhe pesha e denimit te shqiptuar eshte e rregullt. Prandaj, refuzon ankesen e mbrojtjes si te pabazuar.

Sa i perket te pandehurit E.K.

Ne ankese, mbrojtja pretendon qe ne aktgjykimin e ankimuar nuk eshte permendur periudha ne te cilen i pandehuri ka qene i perfshire ne vepren penale. Mbrojtja habitet nese eshte e mundur te kryhet vepra penale e pershkruar ne dispozitivin e aktgjykimit te ankimuar gjate nje apo dy oreve. Adresim i eshte bere gjithashtu ne dispozitiv ku theksohet .. me 5 janar 2012 duke qene i vetedijshem ai nuk ka zbatuar ligjin e punes dhe ka punesuar femije ...".

Nuk eshte kontestuese qe pala e demtuar eshte pranuar nga i pandehuri nga dy njerez te panjohur. Ne momentin kur ai e ka pranuar ate te punoje si valltare ne restorantin e tij me qellim te shfrytezimit ajo nuk ka poseduar dokumente per te deshmuar identitetin e as moshen e saj. Per fillimin e vepres penale te trafikimit te njerezve ne te cilen pala e demtuar eshte e mitur, ligji kerkon formen dhe qellimin e trafikimit. Ne lenden ne Ijale ne i kemi te dy elementet pasi qe i pandehuri ka pranuar palen e demtuar per qellim te shfrytezimit. Prandaj nuk eshte me rendesi se sa gjate ajo ishte nen kontrollin e tij. Fakti qe dy ore pasi qe ajo ka deklaruar qe punon ne restaurant eshte kontrolluar nga policia nuk ndikon ne kryejten e vepres penale ose pergjegjesise per veper te tille penale. Nuk ekziston asnje dyshim qe i pandehuri ka qene i vetedijshem qe veprimet e tij perbejne veper penale pasi qe ai ka keshilluar palen e demtuar qe te largohet nga restoranti ne rast se policia do te vinte.

Kolegji konsideron qe fakti qe shfrytezimi ka qene e nje kohezgatjeje te kufizuar nuk duhet te zbeh ashpersine e vepres penale.

Prandaj, Gjykata Supreme gjen se gjykata e shkalles se pare ne menyre te rregullt ka vertetuar gjendjen faktike dhe ka shpallur te pandehurin fajtores per veprat penale te cilat i viheshin ne barre.

Sa i perket vendimit mbi denimin, duke marre parasysh periudhen e shkurte kohore qe ajo kishte punuar ne restorantin e te pandehurit, kolegji vendosi te ndryshoje aktgjykimin ne pajtim me nenin 420 paragrafin 4 i lidhur me nenin 426 paragrafin 1 te KPPK-se me zbutjen e denimit te shqiptuar per vepren penale te shkeljes se te drejtave te marredhenieve te punes ne dy muaj burgim.

Ne pajtim me nenin 139, paragrafin 1 dhe 2 si dhe nenin 23 te KPK-se, ne lidhje me nenin 66 paragrafin 2 dhe nenin 67 paragrafin 1, nen-paragrafin 2 te KPK-se i pandehuri eshte denuar me burgim prej 1 viti; ne pajtim me nenin 182 te KPK-se i pandehuri eshte denuar me burgim prej dy muaj.

Si pasoje, Gjykata Supreme e Kosoves ne pajtim me nenin 71 paragrafin 1 dhe 2, nen-paragrafin 2 te KPK-se i percakton te pandehurit denim unik me burg ne kohezgjatje prej 1 viti dhe 1 muaji.

*Sa i perket te pandehurit **R.K.***

Mbrojtja pretendon qe gjendja faktike eshte vertetuar ne menyre te gabuar sepse i pandehuri nuk ka kryer veper penale ne asnje kohe dhe menyre per te cilen eshte shpallur fajtores. Eshte e dukshme qe ai kurre nuk ka qene menaxher i restorantit "xxx", por, per arsye se pronari M.K. vuante nga nje semundje e rende ai ishte vetem duke e asistuar ate kur kishte nevojte. Prandaj, ai nuk kishte autoritet te angazhonte A.K. ne restorantin ne fjale. Pala e demtuar e kujton ate vetem si figure dhe kjo mund te vertetohet nga deklaratat e saj te dhena ne prokurori HP.nr.3/2011 te dates 11 janar 2011 dhe gjate shqyrtimit gjyqesor.

I pandehuri **R.K.** ishte denuar per kryeijen e vepres penale te trafikimit te njerezve sepse ne cilesine e ndermjetesit ne mes te pronarit te restorantit ne njeren ane dhe Fatri Toqilla dhe I.I. ne anen tjeter, ka kontribuar ne pranimin e pales se demtuar ne restorantin xxx.

I pandehuri ishte saldues i cili po i kryente veprimtarite e tij ne nje lokal te vogel me qira ne katin perdhese te restorantit xxx. Nuk eshte e diskutueshme qe R.K. e ka ndihmuar pronarin e restorantit ne fjale. Megjithate, ai nuk ka pasur asnje fuqi vendim marrese apo rol vendimtare. Ne lidhje me marredhenien e punes te pales se demtuar ai ne fakt vetem po i percjelite mesazhet nga M.K. tek I.I. dhe F.T. dhe anasjelltas. Fakti qe ai e ka njohur I.I. i cili ka sjelle palen e demtuar se bashku me F.T. nuk e pershine ate automatikisht ne krim. I.I. ishte klient i rregullt ne restorant, ashtu qe ai do te mund te kete gjetur lidhje per te kontaktuar pronarin bile edhe pa ndihmen e R.K.t. Ne anen tjeter, nuk ekzistojne prova qe gjate kesaj ndodhie ai ka tentuar te bind pronarin per te pranuar palen e demtuar nga njerezit qe e kane sjelle ate apo te punesoj per qellim te shfrytezimit.

Gjykata Supreme ka vertetuar qe veprimet e ndermarra nga i pandehuri nuk perbejne elemente te vepres penale me te cilat ishte denuar. Roli i tij ne tere kete ngjaje eshte teresisht jo relevant, pra pohon qe i pandehuri nuk ka bashkepunuar me bashke te pandehurin M.K. per pranimin e pales se demtuar dhe nuk e ka punesuar ate.

Gjykata Supreme perfundon qe nuk mund te vertetoje qe i pandehuri ka kryer veper penale e cila i vihet ne barre.

Duke e marr parasysht ate qe u tha me lart, Gjykata Supreme e liron te pandehurin, ne pajtim te nenit 390 paragrafit 3 lidhur me nenin 420 paragrafin 1 nen paragrafin 4 dhe nenin 426 te KPPK- se.

*Sa i perket te pandehurit **M.K.***

Bazuar ne certifikaten e vdekjes te leshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil, fshati Mupiverc, Komuna e Kamenices, vertetohet qe z. M.K. ka vdekur me 18 qershor 2012. Prandaj, ne baze te nenit 145 te KPPK-se, Gjykata Supreme hedh poshte proceduren penale kunder te ndjerit M.K..

Kryetar i kolegjit:

Francesko Florit

Nesrin Lushta/Gjyqtare e Gjykates Supreme

Emine Mustafa /Gjyqtare e Gjykates Supreme

Salih Toplica/Gjyqtare e Gjykates Supreme

Dr. Horst Proetel, Gjyqtar i EULEX-it

Procesmbajtese

Lendita Berisha/Keshilltare Ligjore

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Ap-Kz. 307/2012

28 shtator 2012

Prishtinë